



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 08
Prishtinë, më 02 Maj 2012, në orën 10:00 salla N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, dhe Albert Kinolli.

Munguan: Ramiz Lladrovci dhe Adem Grabovci.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi dhe Albert Krasniqi- KIPRED, Butrint Ymeri - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.04.2012,
3. Shqyrtimi i propozimit të ZAP-it, për të shtyrë shtypjen e Raportit Vjetor të Performancës dhe publikimin e tij në faqen zyrtare, derisa auditorët e jashtëm të kenë dhënë opinionin dhe rekomandimet e tyre,
4. Njoftimi i Komisionit për Rivlerësimin e ofertave për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011,
5. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.04.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.04.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit të ZAP-it, për të shtyrë shtypjen e Raportit Vjetor të Performancës dhe publikimin e tij në faqen zyrtare, derisa auditorët e jashtëm të kenë dhënë opinionin dhe rekomandimet e tyre

Kryetari – ZAP ka propozuar për të shtyrë shtypjen e RVP-së dhe publikimin e tij në faqen zyrtare derisa auditorët e jashtëm ta kenë dhënë opinionin dhe rekomandimet e tyre. Pasi që kjo është mënyra e vetme për të pasur pamjen e plotë të performancës së një institucioni, qoftë ZAP apo ndonjë institucion tjetër. Sipas Rregullores së Kuvendit dhe fushëveprimtarisë së këtij Komisioni, përzgjedhja e auditorit bëhet nga Kuvendi dhe kjo procedurë e përzgjedhjes së auditorit të jashtëm, akoma s'ka përfunduar. Si rezultat i kësaj nuk është bërë auditimi i pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it.

Ka qenë kërkesë e vazhdueshme e Komisionit që asnjë agjension i pavarur të mos publikoj raportet pa pasqyrat e audituara financiare. Kjo për ZAP-in do të jetë në ngarkesë, sepse auditimi i tyre duhet të kryhet paralelisht me raportet e performancës së OB-ve. Hap diskutimin

Ilire Daija Buza, ZAP – Me datën 30 prill është dorëzuar raporti vjetor i performancës dhe atë në kopje. Ideja ka qenë që raporti i shtypur i ZAP-it të jetë me pasqyrat e audituara financiare dhe kjo të jetë shembull për institucionet e tjera. Raporti i performancës nuk e ka fuqinë e njëjtë nëse nuk e ka opinionin e auditorit të jashtëm. Raporti është dorëzuar zyrtarisht në Kuvend, por propozimi i ZAP-it ka të bëjë vetëm me shtypjen e Raportit.

Armend Zemaj – Propozimi i ZAP-it ka efektin pozitiv, mirëpo pavarësisht pasqyrave financiare të audituara, ligji duhet respektuar. Ligji parasheh që deri më 30 prill raporti duhet dorëzuar, pastaj Komisioni do të shqyrtoj edhe pasqyrat e audituara dhe rekomandimet e Komisionit, pastaj do të procedohen në mbledhje plenare bashkërisht. Sa i përket shqyrtimit të raporteve të performancës bashkë me pasqyrat e audituara të OB-ve që i raportojnë Kuvendit duhet të merren parasysh afatet ligjore që këto OB i kanë të parapara për dorëzimin e raporteve. Ligji duhet respektuar pastaj duhet gjetur modaliteti me komisionet e tjera parlamentare që raportet e OB-ve të shqyrtohen në mbledhje plenare bashkë me pasqyrat e audituara financiare. Komisioni nuk ka nevojë të jap afat shtesë për shtypje ose jo të këtij raporti. E rëndësishme për Komisionin është të respektohet Ligji dhe raporti të procedohet në afatin e paraparë ligjor në Kuvend.

Valbona Dibra- Është për keqardhje që është vonuar përzgjedhja e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011. Propozimi i ZAP-it që shtypja dhe publikimi i raportit të bëhet pasi që të marrin edhe opinionin e auditorëve të jashtëm mund të bëhet, por tani Komisioni ka pranuar raportin e performancës dhe duhet ta shqyrtoj atë duke mos humbur kohë dhe në momentin që bëhet auditimi i pasqyrave financiare, ZAP-i duhet ta shtyp raportin dhe të dërgoi në Kuvend, të cilin pastaj Komisioni do ta shqyrtoj.

Kryetari- Pyeti: sa është e gatshme ZAP-i që në këtë vit të bëjë auditimin e OB-ve në pajtim me afatet kohore të raporteve të performancës të OB-ve.

Ilire Daija Buza, ZAP- Në këtë vit ZAP ka planifikuar që të përgatisë raportet e auditimit për OB-të sipasafateve ligjore që kanë OB-të për raportim në Kuvend. Sipas ligjeve të themelimit të tyre, disa prej të cilave dorëzojnë raport e performancës në fund të muajit prill. Ndërsa, për OB-të që raportet i dorëzojnë në muajin qershor, ZAP ashtu kështu deri më 30 qershor duhet të përfundojnë të gjitha auditimet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- *Komisioni do të shqyrtoj Raportin e performancës të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në mbledhjen e radhës të Komisionit.*
- *Pasqyrat e audituara financiare do të shqyrtohen nga Komisioni pasi që ato të jenë dorëzuara nga auditorët e përzgjedhur nga Kuvendi,*
- *Raporti i performancës së ZAP-it dhe rekomandimet e Komisionit për në mbledhje plenare do të procedohet bashkërisht me pasqyrat e audituara financiare.*

4. Njoftimi i Komisionit për Rivlerësimin e ofertave për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011

Armend Zemaj – Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me rekomandimin e Komisionit për rivlerësimin e ofertave për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011, në bazë të raportit të OSHP-së. Komisioni ka pasur për qëllim respektimin e të gjitha akteve ligjore dhe konkurrencën e barabartë. Edhe pse rivlerësimi i tenderit ka qenë çështje teknike, Komisioni është i detyruar të respektoj ligjin. Edhe vërejtja e Komisionit për zyrën e prokurimit, ka qenë se nuk është përgatitur si duhet dosja e tenderit dhe si rezultat i këtyre Komisioni ka rekomanduar anulimin e tenderit. Kjo me opinion edhe të ekspertit të KRPP-së dhe verifikimin e OSHP-së.

Procedurat duhet respektuar pavarësisht vonesave. Zyra e prokurimit të Kuvendit duhet të ketë kujdes të shtuar në përgatitjen e dosjes së tenderit, por edhe në përdorimin e terminologjisë. Deri në mesin e muajt maj kjo çështje që do të përfundoj.

Kryetari- Komisioni është dashur të bëjë një vlerësim, sepse vet forma e finalizimit përmes të cilës ka kaluar komisioni i dytë i vlerësimit dhe sfida që ka ndodhë është e pakuptimtë për Kuvendin dhe KMFP. Komisioni i dytë gjatë shqyrtimit ka pasur përkrahje nga divizioni i prokurimit dhe ka marrë konfirmimin se gjithçka është në harmoni me dispozitat ligjore. Personalisht ka kërkuar që zyra e prokurimit të jap garancinë të kësaj natyre dhe ka qenë befasia e pakëndshme që pavarësisht të gjithave ka pas shkelje. Këtë çështje e ka shqyrtuar me sekretarin e përkohshme të Kuvendit dhe ka marrë konfirmimin se as nga administrata e kuvendit këtë gjë nuk e ka pritur mirë dhe se udhëheqësi i prokurimit është ndërruar. Në këtë rast administrata ka vepruar drejtë. Edhe pse tenderi ka pasur një vlerë shumë të vogël.

Bali Muharremaj – Komisioni vlerësues nuk ka mundur të tejkaloj procedurat dhe ka qenë në vazhdimësi në konsultim me OSHP-në dhe KRPP-në. Vlera është e vogël, por procedurat janë procedura dhe duhet respektuar ato.

Valbona Dibra – Tha, edhe në vitin e kaluar përzgjedhja është bërë me këto kritere. Gabimi ka qenë te Komisioni i dytë vlerësues i cili ka përzgjedhur operatorin ekonomik më të shtrenjtë dhe ka eliminuar operatorin i cili ka qenë më i lirë edhe pse nuk ka pasur mungesë të dokumentacioneve-licencës. Si rezultat i kësaj ka ardhur deri të vendimi i OSHP-së. Në kushte normale të punës së Kuvendit, kjo nuk duhet të ndodhë.

Kryetari – Komisioni i dytë vlerësues ka qenë në konsultim të plote me udhëheqësin e prokurimit dhe ka marrë garancinë nga zyra e prokurimit se gjithçka është në rregull. Komisioni vlerësues nuk duhet të ngarkohet në këtë drejtim.

Komisioni në vazhdimësi ka pasur vërejtje edhe me OSHP-në, sepse është përfshirë në gabime shumë të mëdha. Në rastin e Këshillit Gjyqësor është pikërisht OSHP-ja ajo e cila ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Pastaj OSHP ka angazhuar ekspert i cili e finalizon procesin e prokurimit te Kuvendit, ndërsa paneli shqyrtues ka vendosur ndryshe.

5. Të ndryshme

a) Vizita në ndonjë institucion

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- *Komisioni do të vizitoi Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.*
- *Në vizitë marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit.*
- *Data e vizitës do të përcaktohet më vonë.*

b) Lista e raporteve të proceduara në Komision.

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se deri më tani në Komision janë proceduar gjithsejtë pesë raporte të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

- Raporti i Auditimit në Efikasitetin, Menaxhimin dhe Monitorimin e Kompanive të Ujit.
- Raporti i Auditimit të Pasqyrave financiare të Zyrës Rregullative të Energjisë (ZRRE)
- Raporti i Auditimit të Pasqyrave financiare të Zyrës Rregullative të Ujërave dhe Mbeturinave (ZRRUM)
- Raporti i Auditimit të Pasqyrave financiare të Akademisë së Shkencave dhe Arteve (ASHAK)
- Raporti i Auditimit të Pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit.

c). Mbledhja e radhës e Komisionit

Meqenëse e mërkura e ardhshme është ditë pushimi, mbledhja e radhës e Komisionit mbahet ditën e martë, datë 08 Maj 2012, ora 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu